



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:016064

Datë: 01.12.2020

Numri i dokumentit: 01309696

**C.nr.141/20**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në trupin e përbërë nga gjyqtarja Florije Qerimi, kryetare e trupit, gjyqtarëve porotë Nazim Shurdhani dhe Nuri Selmani anëtarë të trupit, në çështjen juridike të propozueses L. S, K.Gjilanit, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av.Ymer Huruglica nga Gjilani dhe propozuesit F. I Z. nga Vitia ...pa nr. të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Ajvaz Islami nga Vitia, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim sipas propozimit të përbashkët, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik, të mbajtur me datë 26.11.2020 në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** - propozimi i propozuesve që martesa e lidhur para personit të autorizuar të Z. së Gj. C. në Viti, me date 09.07.2015 e evidentuar me numër rendor 254 dhe me numër të referencës ..., ndërmjet:

**Propozueses L. S**, e lindur me datë ... në Gjilan, nga babai Sh. S. dhe nëna S. S e lindur M., me shtetësi Kosovare dhe

**Propozuesit F. Z**, i lindur më datë... në Viti, nga babai I. Z. dhe nëna R. Z me shtetësi Kosovare, në të cilën martesë nuk kanë patur fëmijë dhe nuk presin fëmijë në afatin e përcaktuar ligjor, **zgjidhet me shkurorëzim.**

**II. Detyrohet Z. e Gj. C.** ...në Viti që ta bëjë ndryshimin sipas këtij Aktgjykimi të plotëfuqishëm në Librin Amëz të Kurorëzuarve dhe në Librin Amëz të të Lindurve.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Fillimisht, propozuesja L. S nga , përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka paraqitur padi për prishjen e kurorës ndaj të paditurit F. Z nga Vitia, në të cilën ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse në fillim raportet kanë qenë të mira, mirëpo meqenëse nuk janë krijuar kushtet për bashkim familjar, pasi që paditësja jeton në botën e

jashtme në Zvicër, këto raporte janë keqësuar deri në atë masë, ashtu që nga fillimi i vitit 2016 këto raporte i kanë shkëputur tërësisht dhe prej atëherë, të njëjtat nuk kanë mundur që të ripërtrihen.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, me të cilin gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

I autorizuari i të paditurit, përmes përgjegjës në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkuespadinë e paditëses si të pabazuar dhe fare të pambështetur në prova relevante materiale.

I autorizuari i të paditurit në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.11.2020 ka deklaruar se dhe për kundër faktit se e ka dorëzuar përgjigjen në padi duke e kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pas marrjes së ftesës nga gjykata e ka ftuar të paditurin dhe ka biseduar lidhur me prishjen e kurorës ku i njëjti është pajtuar që të prishë kurorën edhe ate me marrëveshje-propozim të përbashkët të paditësit ku është pajtuar edhe i autorizuari i paditëses duke i propozuar gjykatës që në pajtim me nenin 68, par.4 të Ligjit Për Familjen i Kosovës, padia të konsiderohet si propozim i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, gjykata duke vlerësuar pajtimin e të paditurit, padinë e paditëses e ka konsideruar propozim të përbashkët të bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës, duke u mbështetur në nenin 68 parag.4, ku shprehimisht thuhet *“Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundim të seancës kryesore deklaron se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje”*, gjykata e konsideron padinë e paditësit si propozim me ç’rast procedura është udhëhequr në bazë të propozimit të përbashkët të palëve ndërgjyqëse.

Po ashtu gjykata konsideron se meqenëse paditësja gjendet me punë jashtë vendit seanca për tentim pajtim nuk mund të realizohet në mes palëve ndërgjyqëse andaj gjykata bazuar në nenin 76 par.1 nënpar.2 të Ligjit Për Familjen i Kosovës, nuk do të tentoj që të mbahet seanca e tentim pajtimit.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit ka administruar këto prova: Çertifikata e martesës në mes të palëve ndërgjyqëse, me nr.serik ..., numër rendor ... e lëshuar më datë 30.01.2020 nga Z. e Gj. C.... në Gjilan.

Meqenëse sipas nenit 84. parag.1 të LFK, kur kemi të bëjmë me marrëveshje të përbashkët për shkurorëzim, faktet e paraqitura në propozim nuk hetohen nga ana e gjykatës, atëherë në procedurën e provave gjykata vetëm ka bërë leximin e tyre dhe ka konstatuar se ndërgjyqësit kanë lidhur martesë tek Sh. i Gj. C. ...në Viti, më datë 09.07.2015, e evidentuar me numër rendor 254 dhe me numër të referencës ..., e që nga kjo bashkësi martesore nuk kanë fëmijë dhe as nuk presin fëmijë në afatin e parapar ligjor.

Gjykata duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 1, lidhur me nenin 69 paragrafi 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, e aprovoi propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 69 paragrafi 2 i LFK-ës, në të cilin citohet se „*Shkaqet e shkurorëzimit janë në mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve... dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme*”.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, ashtu që detyrohet Z. e Gj. C. ... në Gjilan, që ta bëjë ndryshimin sipas këtij aktgjykimi të plotfuqishëm në Librin Amzë të Kurorëzuarve.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 457 para 1 të LPK-së.

Përfaqësuesit e palëve kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës, andaj ky Aktgjykim është bërë i plotfuqishëm ditën e komunikimit me datë 26.11.2020.

Duke u bazuar si më lartë e konform neneve 68.1 dhe nenit 69.2 të LFK lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.141/20, më datë 26.11.2020**

**Kryetarja e trupit – gjyqtarja  
Florije Qerimi**

Kundër këtij Aktgjykimi nuk lejohet ankesa. I njëjti është i plotëfuqishëm më datë 26.11.2020.

Konform nenit 87 të LFK, ankesa është e lejueshme vetëm për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e mashtrimit dhe kërcënimit.